



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E HARTIMIT TË AKTEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I HARTIMIT TË AKTEVE DHE PËRPUTHSHMËRISË**

Nr. 147/4 Prot.

Tiranë, më 20.10.2025

VENDIM

Nr. 56, datë 20.10.2025

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 5, DATË 31.01.2025, TË INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2025”**”

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja “dh”, “ë” dhe “k”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 5, datë 31.01.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025”,

VENDOSA:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 5, datë 31.01.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025”, ndryshohet me lidhjen nr. 1/1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet njësia e inspektorëve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



Lidhja nr. 1/1 – Plani i inspektimeve për vitin 2025

Nr.	Lloji i inspektimit	Objekti i inspektimit	Periudha e realizimit të inspektimit	Organi i inspektuar	Afati i dorëzimit të raportit të inspektimit
1.	Tematik	Ndarja e çështjeve me short, si edhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024.	01.04.2025-31.12.2025	Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	31.12.2025
2.	Tematik	“Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024.	01.04.2025-31.12.2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	31.12.2025
3.	Tematik	Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementëve të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.	01.04.2025-31.12.2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	30.10.2025
4.	Tematik	Mbi kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore me palë kundërshtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm	15.04.2025- 15.11.2025	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	15.11.2025

		Sarandë për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024.			
5.	Tematik	Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024	01.04.2024 – 30.09.2025	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	30.09.2025
6.	Tematik	Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024	01.03.2025 – 31.10.2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	31.10.2025
7.	Tematik	Dokumentimi nga gjyqtarë i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.05.2024 – 31.07.2024	10.02.2025 – 31.03.2025	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	31.03.2025
8.	Institucional	Mbi procesin e qarkullimit të dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari deri në përfundimin e trajtimit të tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024	15.04.2025 – 15.09.2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	15.09.2025
9.	Tematik	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm	20.10.2025- 31.12.2025	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat Gjykata e Shkallës së Parë të	31.12.2025

				Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	
--	--	--	--	--	--